



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:211902

Datë: 09.12.2019

Numri i dokumentit: 00737054

**P.nr.1016/19**

**NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me procesmbajtësen-praktikanten Erza Shamolli, në çështjen penale kundër të pandehurve A.U, U.U dhe D.U qe te tre me vendbanim ne fshatin ..., Komuna Ferizaj, te akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1562-6/2019 e datës 23.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit së shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesit te DBP-së, L.J dhe të pandehurve, me datën. 09.12.2019 solli dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Kundër te pandehurve:**

**1. A.U**, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj , i lindur me dt.09.01.1982, në të njëjtin vend nga i ati I..., dhe e ëma F... , e gjinisë Sh..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka shkollë të kryer, i martuar, baba i dy fëmijëve i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, mbrohet në liri me numër personal ....

**2. U.U**, me vendbanim në fshatin J..., Komuna Ferizaj, i lindur me dt...., në të njëjtin vend nga i ati I..., dhe e ëma F... , e gjinisë Sh..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore , i pa martuar, , i pa punë i gjendjes së varfër ekonomike, mbrohet në liri me numër personal ....

**3. D.U**, me vendbanim në fshatin J..., Komuna Ferizaj , i lindur me dt...., në të njëjtin vend nga i ati I..., dhe e ëma F..., e gjinisë Sh..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën fillore, i pa martua, i pa punë , i gjendjes së varfër ekonomike, mbrohet në liri me numër personal ....

## JANË FAJTORË

Sepse me date 28.08.2019, rreth orës 12:0, ne fshatin ..., komuna Ferizaj ne regjionin ekonomik pyjor Nerodime ..., ne ngastrën 11-te, saktësisht ne pronën e pyjeve shtetërore të cilën menaxhon D.B.P, Komuna Ferizaj, te pandehurit ne bashkëkryerje me qellim te vjedhjes se trungjeve ne pyll, janë takuar nga policia e Stacionit Policor ne Ferizaj, duke prerë drurë pa leje dhe çekan me share motorike te markës “ Husqvarna” të cilat kishin për ti ngarkuar ne traktorin e markës “ IMT 539” ngjyre te kuqe me rimorkio dhe atë :të një trung të llojit ahu, me dimensione të gjata Boniteti III, me diametër 85 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 6,69 m<sup>3</sup> (metra kubë ), me ç’rast të dëmtuarës D.B.P, Komuna Ferizaj, I kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 903,15 Euro,-

Andaj gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 31, 38, 39, 42, 42 43, 69, të KPRK-së ( Kodi nr.06/L-074) dhe neneve 365dhe 450 të KPPRK-së i,

## GJYKON

**I.** Të pandehuri **A.U**, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 100 Euro dhe dënim me burg prej 3/tre/ muajve.

Gjykata konform nenit 43 paragrafi.5 të KPRK-së me pëlqimin e personit të dënuar dënim me gjobë në shumë prej 100 Euro dhe dënimin me burg prej 3/ tre / mujve i’a zëvendëson me urdhrin për punë në dobi të përgjithshëm pa pagesë dhe atë për një periudhë të caktuar kohore prej njëqind e gjashtëdhjetë (160 ) orë pune.

**II.** Të pandehuri **U.U**, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 100 Euro dhe dënim me burg prej 3/tre/ muajve.

Gjykata konform nenit 46 paragrafi.5 të KPRK-së me pëlqimin e personit të dënuar dënim me gjobë në shumë prej 100 Euro dhe dënimin me burg prej 3/ tre / mujve i’a zëvendëson me urdhrin për punë në dobi të përgjithshëm pa pagesë dhe atë për një periudhë të caktuar kohore prej njëqind e gjashtëdhjetë (160 ) orë pune.

**III.** Të pandehuri **D.U**, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 100 Euro dhe dënim me burg prej 3/tre/ muajve.

Gjykata konform nenit 46 paragrafi.5 të KPRK-së me pëlqimin e personit të dënuar dënim me gjobë në shumë prej 100 Euro dhe dënimin me burg prej 3/ tre / muajve i’a zëvendëson me urdhrin për punë në dobi të përgjithshëm pa pagesë dhe atë për një periudhë të caktuar kohore prej njëqind e gjashtëdhjetë (160 ) orë pune.

Shërbimi Sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshëm që duhet kryer nga i dënuari, cakton organizatën e veçantë për të cilën personat e dënuar do të kryejnë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshëm.

Puna në dobi të përgjithshme nga ana e të dënuarit duhet të kryhet brenda gjashtë muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personat e dënuar nuk e kryejnë punën në dobi të përgjithshme ose e kryejnë vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim ku një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë punë në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Obligohen të pandehurit që të dëmtuarës D.B.P në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 903,15 Euro , pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohen të pandehurit A., U... dhe D.U që në mënyrë solidare të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 30 ( tridhjetë) Euro ,dhe secili veç e veç taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

Ne baze te nenit 116 paragrafi 1 të KPPRK-së sendet e komfiskuara ne bazë të nenit 115 paragrafi 2 përkohesisht sharra motorrike e llojit “Husqvarna”, me ngjyre te portokallt, i kthehen të pandehurëve, pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat pandehurve A.U, U.U dhe D.U qe te tre me vendbanim ne fshatin ..., Komuna Ferizaj, te akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale me datën 09.12.2019, mbajti shqyrtimin fillestar konform nenit 245 par.1 të KPPK-së, në të cilin kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesit te DBP-se L.J dhe të pandehurit.

Të pandehurit janë udhëzuar kuptim të nen. 246.1. të KPPK-së, ju është dhënë mundësia të deklarohen lidhur me pranimin ose mos pranimin e fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohen.

Në vazhdim të shqyrtimit fillestar nga salla janë larguar dy të pandehurit të tjer kure në sall ka qëndruar i pandehuri i parë dhe pas deklarimit të ti gjykata sipas radhës do ti ftoj në sallën e gjykimit.

I pandehuri A.U, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke shtuar se është e vërtetë se ditën për të cilën akuzohet, së bashku me vëllezërit e mi U... dhe D... ka shkuar në pyll me traktor dhe kur kemi filluar duke i ngreh drutë e prera kanë arritur policia ku na kanë shoqëruar në Stacionin Policor Ferizaj për të dhënë deklaratë ku kemi dhënë e më pas edhe në prokurori për këtë rast. Pasi kemi kushtet e vështira ekonomike nuk kemi pas mundësi me i ble kemi shkua që drutë ti sigurojmë për nevoja të familjes i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

I pandehuri U.U në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në tersi mbështes deklaratën që kamë dhënë në polici dhe prokurori për këtë ku atë ditë së bashku me vëllezërit A... dhe D... kemi shkua në mal në fshatin ... ku kemi mbërri diku ora 12:00 h, dhe në momentin kur kanë arritur policia ne ishim duke i bartur drunjte nga vendi ku i kemi prerë ku edhe na kanë arrestuar, më vjen keq që kam shkuar me pre drunjte pa leje dhe pa pagesë por zgjedhje tjetër nuk kemi pas sepse asnjëri nuk punoj askund dhe qëllimi ynë ka qenë që ti sigurojmë drutë për shtëpinë ton e jo për shitje, i propozoj gjykatë që të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

I pandehuri D.U, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim deklaron se atë ditë së bashku me vëllezërit kanë marrë traktorin dhe sharrën motorike ku nuk kemi pasur leje për prerje të drunjteve por i kemi prerë pasi nuk kemi pas mundësi që ti blejmë jemi që të tre të pa punë i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr të gjitha rrethanat lehtësuese.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga të pandehurit pasi pranimi i fajësisë mbështetet në aktin akuzues dhe provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe ti shqipton sanksion të paraparë me ligj.

Gjyqtari gjykues në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar konstaton se i akuzuari pranimin e fajësisë e mbështeti në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë në raportin e policit hetues i datës 28.08.2019, vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve, i datës 28.08.2019, raporti i dëmit pyjor në Rajonn ... 1, i dt.29.08.2019, raporti i policit hetues i dt.04.09.2019, raporti mbi vlerësimin dhe konstatimin e dëmit të shkaktuar nga D.B.P në Ferizaj Nr.91/2019 i dt.29.08.2019, dhe shkresat e tjera të lëndës.

*Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata vërtetoi se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e pyllit në vazhdim nga neni 349 par.1 të KPRK-së.*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, Si rrethane lehtësuese gjykata mori parasysh faktin se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale, i gjendjes së varfër ekonomike, kanë theksuar se drutë i ka marruar për nevoja të familjes e jo për destininim shitje mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit, ka patuar parasysh gjendjen e tyre ekonomike dhe se kanë deklaruar se janë të pa punë dhe pas shpalljes së aktgjykimit të njëjtëve veç e veç me pëlqimin e tyre në mënyrë komulative i'a zëvendëson me Urdhër për Punë në Dobi të Përgjithshëm secilit të pandehur nga njëqind e gjashtëdhjetë orë (160) orë pune, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të pandehurve dhe me te arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës D.B.P, dhe Zhvillim Rural Komuna Ferizaj, / DBPZHR-së /, ti kompensoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 903,15 euro, / nëntëqind e tre euro e pesëmbëdhjetë cent / në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
**P.nr.1016/19, me datë 09.12.2019**

**Procesmbajtëse**  
Erza Shamolli

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.